



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ekspteri Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florie Salihu	17.06.2026	24.06.2026	2026/0393

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.06.2026, OE “MetBat SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0393, kundër **njoftimit për anulimi të aktivitetit të prokurimit**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Paketimi, transporti dhe varrosja e mbetjeve indore dhe placentat” me nr. të prokurimit: "220/70100-26-3320-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur të hapur, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 40,500.00 €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik Neni

43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Në vijim po bashkangjes:

Kërkesën për rishqyrtim të OE kundrejt AK;

Vendimin e AK ndaj Kërkesës për Rishqyrtim si dhe;

Ankesën e OE drejtuar Organit Shqyrtues të Prokurimit Kërkesa për rishqyrtim:

Kërkesa për rishqyrtim:

Pretendimi:

Të nderuar ne me dt.05.06.2026 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2/ është kërkuar në DT Kërkesa 1. Kërkohet që OE të ketë Vendim për Autorizim Mjedisor Evidenca 1 Vendim për Autorizim Mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për trajtimin e mbeturinave patologjike Në ofertën e dorëzuar ju mungon Vendimi për Autorizim Mjedisor.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se ne në ofertën tonë kemi dorëzuar Lejen Mjedisore si dhe deklaratën për Autorizim Mjedisor, në të cilën është sqaruar qartë se ne si OE posedojmë Leje Mjedisore të lëshuar nga organi kompetent dhe se në përputhje me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MEA Nr. 01/21 për Autorizim Mjedisor, kompanitë të cilat posedojnë lejen mjedisore nuk janë të obliguara të pajisen me Autorizim Mjedisor për aktivitetin në fjalë. Në deklaratë ne e kemi specifikuar qartë se kompania jonë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit përmes Lejes Mjedisore dhe se detyrimi ligjor konsiston vetëm në njoftimin e Ministrisë përkatëse në momentin e kryerjes së shërbimit. Autoriteti kontraktues në arsyetimin e saj nuk ka paraqitur asnjë bazë ligjore që dëshmon se posedimi i Lejes Mjedisore nuk është i mjaftueshëm apo se operatori ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi ka qenë i obliguar të pajiset me Autorizim Mjedisor. Përkundrazi, deklaratat e dorëzuar nga ne i referohet drejtpërdrejt dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore që përjashtojnë operatorin ekonomik nga obligimi për nxjerrjen e Autorizimit Mjedisor. Nga këto fakte kuptohet qartë se, autoriteti kontraktues ka qenë i obliguar të analizoi dokumentacionin në tërësi dhe nëse ka pasur paqartësi lidhur me interpretimin e dokumentit ose

statusin ligjor të operatorit ekonomik, të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, e jo të eliminojë ofertën tonë pa verifikuar faktet dhe bazën ligjore të paraqitur.

Pra për çdo paqartësi që AK-ja ka pasur e njëjta është dashur ti drejtohet edhe organeve kompetente të MMPHI dhe ta sqarojë se si duhet të interpretohet neni 6 i Udhëzimit Administrativ MEA Nr.01/21 Për Autorizim Mjedisor, me nr. protokoll 01-M-307-2/21 të dt.28.01.2021 edhe pse në këtë rast nuk ka nevojë fare të kërkohej sqarime, pasi që çdo gjë është e qartë sipas dispozitës së lartcekur. Eliminimi i ofertës sonë për mungesë të një dokumenti që ligjërisht nuk kërkohet për operatorin ekonomik në fjalë përbën interpretim të gabuar të kërkesave të dosjes së tenderit dhe tregon qartë diskriminimin që i është bërë kompanisë tonë, pasi që jemi eliminuar për mosdorëzimin e një dokumenti që nuk është i detyrueshëm për ne si kompani që posedojmë lejen mjedisore sipas legjislacionit në fuqi.

Prandaj kërkojmë që të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së, lënda të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit të kërkohej sqarime edhe nga MMPHI dhe pastaj të bëhet pranimi i dokumentacionit të dorëzuar si dëshmi e mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së specifikuar në dosje të tenderit, për autorizim mjedisor. Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi fitues të këtij tenderi, ndërsa anulimi i aktivitetit është në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-së. Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP Nr.001/2022 sepse nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita duke pasur parasysh që ne jemi ofertues i përgjegjshëm. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos na rekomanduar për kontratë. Po ashtu nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Vendimi i AK ndaj Kërkesës për Rishqyrtim:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "MetBat SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Paketimi, transporti dhe varrosja e mbetjeve indore dhe placentat" me numër të prokurimit: "220/70100-26-3320-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

Përgjigje nga AK ne pretendimet Ankimore:

I. Rrethanat faktike dhe procedurale

Autoriteti Kontraktues – QKUK ka publikuar aktivitet te prokurimit për: "Paketimi, transporti dhe varrosja e mbetjeve indore dhe placentat", me numër prokurimi 220/70100-26-3320-2-2-1.

Vetë titulli i aktivitetit e specifikon shprehimisht "varrosja" si metodë e vetme e parashikuar e asgjësimit, duke përjashtuar çdo metodë alternative. Dosja e Tenderit, në përputhje me titullin e aktivitetit, ka parashikuar si kërkesë për kapacitet teknik dhe profesional (pika 9.1 dhe 9.2) dorëzimin e Vendimit për Autorizim Mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për trajtimin e mbeturinave patologjike (Evidenca 1).

transferim ka probleme substanciale ligjore që e bëjnë dokumentin të papranueshëm si dëshmi kualifikuese:

Së pari, vendimi i transferimit specifikon se MetBat trashëgon Lejen Mjedisore të Integruar "për impiantin për shkrirjen e mbeturinave metalike" në Sankoc, Gllogoc – jo për asgjësimin e mbeturinave patologjike spitalore. Kjo do të thotë se edhe nëse transferimi do të qëndronte, fusha e mbulimit të lejes nuk korrespondon me aktivitetin e tenderit, i cili kërkon kapacitet për trajtimin e mbeturinave patologjike/indore, jo për shkrirje të mbeturinave metalike.

Së dyti, Leja Mjedisore origjinale është lëshuar për KMI SH.P.K. dhe ka futur si aktivitet kryesor **djegien e mbeturinave spitalore dhe medicinale** – jo varrosjen, e cila është metoda e kërkuar shprehimisht nga ky tender. Kjo konfirmon mospërputhjen e dyfishtë: edhe subjektin (KMI jo MetBat), edhe metodën e trajtimit (djegia jo varrosja).

Prandaj, dokumenti i dorëzuar nuk mund të pranohet si dëshmi e kapacitetit teknik dhe profesional të MetBat SH.P.K. për realizimin e aktivitetit të prokurimit.

3. Leja Mjedisore e Integruar dhe Autorizimi Mjedisor janë instrumente juridike të ndryshme dhe njëri nuk e zëvendëson tjetrin

Edhe duke lënë mënjanë problemin e titullarit dhe fushës së mbulimit, pretendimi i OE ankues se Leja Mjedisore zëvendëson Vendimin për Autorizim Mjedisor mbetet i pabazuar në vetë tekstin e UA MEA Nr. 01/21. Neni 3.1 e definon Autorizimin Mjedisor si dokument zyrtar të lëshuar me shkrim nga Ministria, me të cilin i lejohe bartësit të zhvillojë aktivitetin vetëm një herë, ndërsa neni 1.5 e definon Lejen e Përkatëse Mjedisore si një kategori krejtësisht të ndryshme dokumentesh – Leje Mjedisore e Integruar, Leje Mjedisore, ose Leje Mjedisore Komunale. Janë instrumente me natyrë, qëllim dhe baza ligjore të ndryshme, dhe asnjë dispozitë ligjore nuk i bën të këmbyeshme me njëri-tjetrin.

4. Neni 6 i UA MEA Nr. 01/21 rregullon detyrimin administrativ ndaj Ministrisë dhe nuk ka të bëjë me kualifikimin e OE-ve në procedura prokurimi

OE ankues bazohet tek neni 6, paragrafi 1 i UA MEA Nr. 01/21, duke pretenduar se si kompani me leje mjedisore nuk ka nevojë për Autorizim Mjedisor. Ky pretendim ngatërron dy sfera juridike krejtësisht të ndryshme. Dispozita e cituar rregullon detyrimin administrativ të subjekteve ndaj Ministrisë – domethënë kur një subjekt nuk ka nevojë të aplikojë për Autorizim Mjedisor si procedurë administrative. Kjo dispozitë nuk ka asnjë lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë në procedura prokurimi, ku kërkesat e dosjes vendosen nga Autoriteti Kontraktues sipas nenit 27 të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Neni 6 i UA MEA Nr. 01/21 nuk mund të interpretohet asnjëherë si bazë

për zëvendësimin e dokumenteve kualifikuese të parashikuara shprehimisht në Dosjen e Tenderit. Ky qëndrim është konfirmuar edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit me Vendimin nr. 2023/0929, datë 08.02.2024, i cili ka trajtuar ankesën e ngjajshme.

5. AK nuk kishte obligim ligjor për kërkimin e sqarimeve sipas neneve 59.2 dhe 72 të LPP-së

Pretendimi se AK-ja duhej të kërkonte sqarime para eliminimit nuk qëndron. Nenet 59.2 dhe 72 të LPP-së lejojnë AK-në të kërkojë sqarime kur ka paqartësi në dokumentacionin e dorëzuar. Mirëpo rrethanat e këtij rasti janë krejtësisht të ndryshme: dokumenti i kërkuar – Vendimi për Autorizim Mjedisor – mungonte plotësisht nga oferta. Sqarimet nuk mund të shërbejnë si mjet për plotësimin retroaktiv të dokumenteve kualifikuese, pasi kjo do të shkelte parimin e barazisë dhe jo-diskriminimit të parashikuar në nenin 7 të LPP-së dhe do të dëmtonte integritetin e procedurës. Pranimi i dokumenteve alternative pas afatit do të diskriminonte çdo OE tjetër që ka respektuar kërkesat e dosjes.

III. Konkluzion

Duke u mbështetur në tërësinë e gjetjeve dhe argumenteve ligjore të parashtruara, AK-QKUK konstaton se oferta e MetBat SH.P.K. paraqet mangësi të shumëfishta dhe themelore. Vendimi për Autorizim Mjedisor mungon plotësisht. Leja Mjedisore e dorëzuar i takon një kompanie tjetër – KMI SH.P.K. – dhe jo ofertuesit MetBat SH.P.K.; edhe vendimi i transferimit nuk e rregullon këtë problem, pasi ai specifikon aktivitetin e shkrirjes së mbeturinave metalike, jo trajtimin e mbeturinave patologjike të kërkuar nga ky tender. Përveç kësaj, Leja Mjedisore dhe Autorizimi Mjedisor janë instrumente juridike të ndryshme dhe të pakëmbyeshme; neni 6 i UA MEA Nr. 01/21 nuk zbatohet si bazë kualifikimi në procedura prokurimi; dhe AK nuk kishte obligim ligjor për sqarime kur dokumenti mungonte tërësisht. Për të gjitha këto arsye, AK-QKUK vendos të refuzojë kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në përputhje me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik.

Ankesa e OE drejtuar Organit Shqyrtues të Prokurimit:

Të nderuar ne me dt.05.06.2026 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2/ është kërkuar në DT

Kërkesa 1. Kërkohet që OE të ketë Vendim për Autorizim Mjedisor

Evidenca 1 Vendim për Autorizim Mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësiror për trajtimin e mbeturinave patologjike

Në ofertën e dorzuar ju mungon Vendimi për Autorizim Mjedisor

3/6

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se ne në ofertën tonë kemi dorëzuar Lejen Mjedisore si dhe deklaratën për Autorizim Mjedisor, në të cilën është sqaruar qartë se ne si OE posedojmë Leje Mjedisore të lëshuar nga organi kompetent dhe se në përputhje me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MEA Nr. 01/21 për Autorizim Mjedisor, kompanitë të cilat posedojnë lejen mjedisore nuk janë të obliguara të pajisen me Autorizim Mjedisor për aktivitetin në fjalë. Në deklaratë ne e kemi specifikuar qartë se kompania jonë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit përmes Lejes Mjedisore dhe se detyrimi ligjor konsiston vetëm në njoftimin e Ministrisë përkatëse në momentin e kryerjes së shërbimit.

Autoriteti kontraktues në arsyetimin e saj nuk ka paraqitur asnjë bazë ligjore që dëshmon se posedimi i Lejes Mjedisore nuk është i mjaftueshëm apo se operatori ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi, ka qenë i obliguar të pajiset me Autorizim Mjedisor. Përkundrazi, deklarata e dorëzuar nga ne i referohet drejtpërdrejt dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore që përjashtojnë operatorin ekonomik nga obligimi për nxjerrjen e Autorizimit Mjedisor. Nga këto fakte kuptohet qartë se, autoriteti kontraktues ka qenë i obliguar të analizoj dokumentacionin në tërësi dhe nëse ka pasur paqartësi lidhur me interpretimin e dokumentit ose statusin ligjor të operatorit ekonomik, të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, e jo të eliminojë ofertën tonë pa verifikuar faktet dhe bazën ligjore të paraqitur. Pra për çdo paqartësi që AK-ja ka pasur e njëjta është dashur ti drejtohet edhe organeve kompetente të MMPHI dhe ta sqarojë se si duhet të interpretohet neni 6 i Udhëzimit Administrativ MEA Nr.01/21 Për Autorizim Mjedisor, me nr. protokoli 01-M-307-2/21 të dt.28.01.2021 edhe pse në këtë rast nuk ka nevojë fare të kërkojen sqarime, pasi që çdo gjë është e qartë sipas dispozitës së lartcekur.

Eliminimi i ofertës sonë për mungesë të një dokumenti që ligjërisht nuk kërkohet për operatorin ekonomik në fjalë përbën interpretim të gabuar të kërkesave të dosjes së tenderit dhe tregon qartë diskriminimin që i është bërë kompanisë tonë, pasi që jemi eliminuar për mosdorëzimin e një dokumenti që nuk është i detyrueshëm për ne si kompani që posedojmë lejen mjedisore sipas legjislacionit në fuqi.

Prandaj kërkojmë që të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së, lënda të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit të kërkohen sqarime edhe nga MMPHI dhe pastaj të bëhet pranimi i dokumentacionit të dorëzuar si dëshmi e mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së specifikuar në dosje të tenderit, për autorizim mjedisor.

Ne me dt.10.06.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që në asnjë mënyrë AK-ja nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ka pretenduar se Leja Mjedisore e Integruar e dorëzuar nga ne nuk mund të merret si dëshmi e vlefshme, duke u arsyetuar se e njëjta fillimisht është lëshuar për një subjekt tjetër ekonomik. Ky pretendim nuk qëndron, pasi që ne si operator ekonomik e kemi dorëzuar në ofertë jo vetëm Lejen Mjedisore, por edhe dokumentacionin përkatës për bartjen e saj tek kompania jonë, të lëshuar nga organet kompetente. Prandaj, e drejta për shfrytëzimin e kësaj leje i takon kompanisë sonë dhe dokumenti duhej të vlerësohej si pjesë përbërëse e kapacitetit tonë teknik dhe profesional dhe jo të nxjerrën arsyetime të tilla, të cilat tregojnë qartë diskriminimin që po na bëhet neve si kompani e përgjegjshme.

Duhet cekur fakti se kjo çështje nuk ka qenë arsye e eliminimit tonë sipas letrës standarde për tenderues të eliminuar. Arsye e vetme e eliminimit ka qenë mungesa e pretenduar e Autorizimit Mjedisor. Nga ky fakt kuptohet qartë se, AK-ja gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim pasi që nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, ka paraqitur në vendimin për refuzim të kërkesës arsye të reja që nuk kanë qenë pjesë e vendimit fillestar për eliminim dhe që të njëjtat edhe tani janë të paqëndrueshme.

Një veprim i tillë nga ana e AK-së është i kundërligjshëm dhe diskriminues, pasi që arsyet të cilat i ka cekur tani, ne nuk ishim njoftuar paraprakisht me njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe të njëjtat arsye nuk kemi pasur mundësi t'i kundërshtojmë në momentin e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Mirëpo edhe përkundër këtij fakti ne po e sqarojmë se e kemi dorëzuar lejen mjedisore të integruar e cila është në harmoni edhe me Udhëzimin Administrativ MEA Nr. 01/21 për Autorizim Mjedisor.

Lidhur me pretendimin e AK-së se operatori ekonomik nuk e ka dorëzuar Autorizimin Mjedisor, theksojmë se ne kemi dorëzuar deklaratën përkatëse në të cilën kemi sqaruar bazën ligjore pse kompania jonë nuk është e obliguar të pajiset me autorizim. Në deklaratën e dorëzuar ne i jemi referuar qartë nenit 6 të Udhëzimit Administrativ MEA Nr. 01/21 për Autorizim Mjedisor, sipas të cilit operatorët ekonomikë që posedojnë Leje Mjedisore nuk janë të obliguar të pajisen edhe me Autorizim Mjedisor për ushtrimin e aktivitetit përkatës. AK-ja në vendimin për rishqyrtim pretendon se Leja Mjedisore dhe Autorizimi Mjedisor janë dokumente të ndryshme, mirëpo çështja kontestuese nuk është nëse këto dokumente janë të ndryshme, por nëse operatori ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi, ka qenë i obliguar të posedojë të dy dokumentet njëkohësisht. Ne kemi argumentuar dhe dokumentuar qartë se bazuar në nenin 6 të UA Nr. 01/21, posedimi i Lejes Mjedisore e përjashton operatorin ekonomik nga obligimi për t'u pajisur edhe me Autorizim Mjedisor. AK nuk ka ofruar asnjë bazë ligjore që e tregon të kundërtën e argumentit tonë dhe si përfundim nuk ka dëshmuar se eliminimi ynë është bërë mbi një bazë të qëndrueshme ligjore.

Për më tepër, kërkesa e dosjes së tenderit ka pasur për qëllim të dëshmojë se operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht për ushtrimin e aktivitetit përkatës. Përderisa ne e kemi dëshmuar se e posedojmë Lejen Mjedisore dhe e kemi sqaruar bazën ligjore ku specifikohet që OE që posedon leje mjedisore nuk është e nevojshme të pajiset me Autorizim Mjedisor, atëherë kuptohet qartë se ne e kemi përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit. Edhe përkundër fakteve të lartcekura, AK-ja tani po mundohet që me çdo kusht të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit duke nxjerr arsye krejtësisht të pa bazuara në lidhje me lejen mjedisore të dorëzuar nga ana jonë.

AK-ja poashtu ka pretenduar se neni 6 i UA MEA Nr. 01/21 rregullon vetëm detyrimin administrativ ndaj Ministrisë dhe nuk ka të bëjë me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, mirëpo një arsyetim i tillë është i pabazuar. Ne nuk i jemi referuar këtij neni për të dëshmuar kualifikimin tonë, por për të dëshmuar se sipas legjislacionit në fuqi nuk kemi obligim ligjor të pajisemi me Autorizim Mjedisor. Për rrjedhojë, neni 6 është drejtpërdrejt relevant për vlerësimin e kërkesës së AK-së, pasi përcakton nëse operatori ekonomik ka apo jo detyrim ligjor për të poseduar dokumentin e kërkuar

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "MetBat SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Paketimi, transporti dhe varrosja e mbetjeve indore dhe placentat" me numër të prokurimit: "220/70100-26-3320-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

Nëse eventualisht në një procedurë prokurimi do të kërkohej një autorizim i caktuar, ndërsa ligji përkatës do të parashihte se operatori ekonomik nuk ka obligim të pajiset me atë autorizim, atëherë autoriteti kontraktues do të duhej ta merrte parasysh atë dispozitë ligjore. E njëjta situatë është edhe në rastin tonë. Neni 6 i UA MEA Nr. 01/21 është pikërisht dispozita që përcakton nëse ekziston apo jo obligimi për pajisje me Autorizim Mjedisor dhe për këtë arsye nuk mund të shpërfilllet nga AK gjatë vlerësimit të ofertës.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi fitues të këtij tenderi, ndërsa anulimi i aktivitetit është në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-së.

Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP Nr.001/2022 sepse nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita duke pasur parasysh që ne jemi ofertues i përgjegjshëm.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos na rekomanduar për kontratë.

Po ashtu nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

- I. **APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE MetBat SH.P.K.
- II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e Tendeit, Kërkesat e nenit 69 të Ligjit të Prokurimit, Vendimi i OSHP me Nr. 0929/23 i lëshuar me datë: 08.02.2024, kërkesa për rishqyrtim dhe vendimi i AK ndaj kërkesës për Ri-

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "MetBat SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Paketimi, transporti dhe varrosja e mbetjeve indore dhe placental" me numër të prokurimit: "220/70100-26-3320-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

shqyrtim si dhe dokumente tjera relevante.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

I pa-përgjegjshëm administrativisht

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues konsiderohet palë me interes sipas nenit 4, paragrafi 1.26 të LPP-së

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP me Nr. 0929/23 i lëshuar me datë: 08.02.2024

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

Nuk ka devijim por ne Vendimin e lart permendur eshte rregulluar vetem nje qeshtje, perkatësisht janë vertetuar si ne perputhje me ligjin kerkesat e parashtruara nga AK sa i perket objektit të kontratës.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - MetBat SH.P.K.

I. OBJEKTI I SHQYRTIMIT

Objekt i këtij raporti të ekspertizës është shqyrtimi i pretendimeve ankimore të Operatorit Ekonomik "MetBat SH.P.K." lidhur me vendimin e Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit, si dhe vlerësimi i përputhshmërisë së këtij vendimi me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Në kuadër të këtij shqyrtimi janë analizuar në veçanti:

- përmbushja e kërkesave teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit;

- vlefshmëria dhe relevanca e Lejes Mjedisore të Integruar të dorëzuar nga Operatori Ekonomik;
- aplikimi dhe interpretimi i dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik;
- aplikimi dhe interpretimi i dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MEA) Nr. 01/21 për Autorizim Mjedisor.

II. PRETENDIMET E PALËVE

1. Pretendimet e OE

OE pretendon se:

- ka dorëzuar Leje Mjedisore të Integruar të vlefshme dhe të transferuar ligjërisht në emër të tij
- posedon kapacitet të mjaftueshëm për trajtimin e mbetjeve spitalore
- eliminimi është i pabazuar pasi posedimi i lejes mjedisore e përjashton obligimin për Autorizim Mjedisor sipas nenit 6 të UA Nr. 01/21
- AK nuk ka argumentuar në mënyrë të mjaftueshme kundërshtimin e pretendimeve të tij
- kërkohet që AK të kishte kërkuar sqarime sipas nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe të vlerësonte në mënyrë substanciale dokumentacionin

2. Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

AK thekson se:

- Dosja e tenderit kërkon shprehimisht **varrosjen e mbetjeve indore dhe placentave**
- AK pretendon se Leja Mjedisore e dorëzuar autorizon operimin e një impianti për djegie. (incinerim) dhe nuk mbulon metodën e kërkuar të varrosjes .
- AK pretendon se Leja Mjedisore e Integruar fillimisht është lëshuar për një subjekt tjetër ekonomik dhe se dokumentacioni i transferimit të paraqitur nga OE nuk dëshmon se leja e transferuar mbulon aktivitetin specifik të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve patologjike/spitalore që janë objekt i këtij aktiviteti të prokurimit.
- Neni 6 i UA Nr. 01/21 nuk është relevant për zëvendësimin e kërkesave kualifikuese të dosjes së tenderit

III. ANALIZA JURIDIKE DHE TEKNIKE

1. Kërkesa e dosjes së tenderit

Specifikimi teknik përcakton qartë:

- Paketimi, transporti dhe **varrosja e placentave**
- Paketimi, transporti dhe **varrosja e mbetjeve indore me enë plastike dhe formalinë**

Elementi "varrosja" paraqet metodën e detyrueshme të asgjësimit të mbetjeve.

2. Përmbajtja e Lejes Mjedisore të Integruar

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se:

- Leja autorizon operimin e **impiantit për djegie (incinerim)** të mbetjeve spitalore/medicinale
- Leja nuk përmban dispozita të qarta që e autorizojnë metodën e varrosjes së mbetjeve në kuptimin e kërkesës së dosjes së tenderit

3. Natyrë juridike e metodave të trajtimit

Eksperti vlerëson se:

- **Varrosja dhe djegia (incinerimi)** janë dy metoda të ndryshme të trajtimit të mbetjeve
- ato kërkojnë kushte, teknologji dhe leje të ndryshme mjedisore
- nuk mund të konsiderohen ekuivalente në mungesë të një baze eksplicite ligjore ose të dosjes së tenderit

4. Mbi përputhshmërinë teknike

Krahasimi i kërkesës së dosjes me lejen e dorëzuar:

Kërkesa e dosjes	Leja e dorëzuar
------------------	-----------------

Varrosje e mbetjeve indore	Djegie (incinerim)
----------------------------	--------------------

Varrosje e placentave	Djegie (incinerim)
-----------------------	--------------------

Konstatohet mospërputhje substanciale në metodën e trajtimit të mbetjeve.

5. Mbi nenin 6 të UA Nr. 01/21

Eksperti vlerëson se:

- Neni 6 i UA Nr. 01/21 parashikon përjashtime nga obligimi për pajisje me Autorizim Mjedisor në kushte të caktuara.
- Megjithatë, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet në mënyrë të pavarur dhe të izoluar nga kërkesat e dosjes së tenderit.
- Aplikimi i nenit 6 do të ishte i pranueshëm vetëm nëse Leja Mjedisore e dorëzuar do të mbulonte në mënyrë të qartë aktivitetin specifik të kërkuar në tender (varrosjen e mbetjeve indore dhe placentave).
- Në mungesë të kësaj përputhshmërie, dispozita nuk prodhon efekt zëvendësues.

6. Mbi nenet 59 dhe 72 të LPP-së (sqarime shitesë)

Eksperti vlerëson se:

- Autoriteti Kontraktues ka pasur të drejtë, por jo obligim absolut, të kërkojë sqarime shitesë nga OE
- përdorimi i kësaj kompetence mbetet në diskrecionin e AK-së, veçanërisht kur dokumentacioni vlerësohet si i pamjaftueshëm në aspekt substancial
- Moskërkimi i sqarimeve në vetvete nuk përbën shkelje procedurale

7. Mbi arsyetimin e vendimit të AK-së

Eksperti vlerëson se:

Njoftimi fillestar i eliminimit duhet të përmbajë arsyet kryesore të moskualifikimit të Operatorit Ekonomik.

Vendimi ndaj kërkesës për rishqyrtim përmban elaborim më të zgjeruar juridik dhe teknik të arsyetimit të dhënë.

Autoriteti Kontraktues nuk është i detyruar që në njoftimin fillestar të eliminimit të përfshijë të gjitha detajet e arsyetimit, për sa kohë që baza thelbësore e vendimit të eliminimit është e qartë dhe e kuptueshme për Operatorin Ekonomik

8. Mbi përputhshmërinë e lejes me objektin e tenderit

Eksperti thekson se:

- Leja mjedisore duhet të jetë në përputhje substanciale me aktivitetin e përcaktuar në dosjen e tenderit;
- Në rastin konkret, leja e dorëzuar autorizon operimin e një impianti për djegie (incinerim), ndërsa dosja e tenderit kërkon metodën e varrosjes së mbetjeve;

Rrjedhimisht, konstatohet ekzistenca e mospërputhjes teknike dhe substanciale ndërmjet dokumentit kualifikues të dorëzuar dhe kërkesës së përcaktuar në dosjen e tenderit.

IV. KONSTATIMET E EKSPERTIT

Pas analizës së dokumentacionit dhe pretendimeve të palëve, konstatohet se:

1. Dosja e tenderit kërkon shprehimisht metodën e **varrosjes së mbetjeve indore dhe placentave**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "MetBat SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Paketimi, transporti dhe varrosja e mbetjeve indore dhe placentat" me numër të prokurimit: "220/70100-26-3320-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

2. Leja Mjedisore e Integruar e dorëzuar autorizon vetëm **djegje (incinerim)**
3. Nuk ekziston përputhje substanciale ndërmjet metodës së kërkuar dhe asaj të autorizuar në leje
4. Dispozitat e nenit 6 të UA Nr. 01/21 nuk janë të aplikueshme në mungesë të përputhshmërisë së aktivitetit
5. Pretendimet e OE lidhur me sqarimet shitesë kanë karakter të mundësisë diskrecionale të AK-së dhe nuk nënkuptojnë ekzistencë të një detyrimi të obligueshëm sipas neneve 59 dhe 72 të LPP-së, veçanërisht në rastet kur dokumenti i kërkuar nuk është dorëzuar dhe dokumenti i paraqitur nuk konsiderohet ekuivalent në kuptim substancial me kërkesat e dosjes së tenderit.
6. Autoriteti Kontraktues ka vepruar brenda hapësirës së tij vlerësuese (diskrecionale) në interpretimin e kërkesave teknike

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK perkatsisht "Njofimi Mbi Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit" B58.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "MetBat SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Paketimi, transporti dhe varrosja e mbetjeve indore dhe placentat" me numër të prokurimit: "220/70100-26-3320-2-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – MetBat SH.P.K.



Florie Salihu

